



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE
DREJTORI EKZEKUTIV

Lidhja 1

Kërkesa për miratimin e Planit Vjetor të Punës të ushtrimit të aktivitetit mineral, që depoziton çdo subjekt mineral për shqyrtimin e planit vjetor të punës duhet të shoqërohet me dokumentacionin si vijon;

I. Dokumentacioni Teknik:

1. Formularin e deklaramit të aktivitetit mineral sipas Urdhërit të Ministrit Nr. 201 & 202, datë 20.06.2016 - Ministria e Energjisë dhe Industrisë;
2. Analiza tekniko-ekonomike për vitin e kaluar dhe programi i punës për vitin e ardhshëm;
3. Për pjesën ku punohet, për minierat sipërfaqësore, rievim topografik në shkallë 1:500 ose 1:1000, për pjesën tjetër në shkallë më të vogël në varësi të sipërfaqes, ndërsa për minierat nëntokësore, sipas rastit, për punimet e bllokut të shfrytëzimit në shkallë më të mëdha (1: 200 dhe 1:500);
4. Bilanci i lëvizjes së rezervave i argumentuar me material shoqërues grafik (prerje, projektion, dokumentim, gjeometrizim) dhe përshkrimor;
5. Lejen e lëndës plasëse në emër të subjektit, që zotëron lejen minerare;

II. Dokumentacioni Ekonomik:

1. Aneksi 2, me deklarimet e realizimeve të produkteve të prodhuara, shitjeve të tyre si dhe të pagesës së rentës;
2. Tabelën përmbledhëse për shitjet;
3. Pagesat e rentës ose vërtetim për vlerën e paguar të rentës në rastet e eksportit;
4. Pagesën e garancisë së rehabilitimit;
5. Pagesën e garancise se investimit për subjektet, që aplikojne për herë të parë për miratimin e planit vjetor;
6. Dokument për pagesën e taksave vendore sipas formatit të lëshuar nga Njësia Vendore (në rast detyrimesh të paraqesë marrëveshjen me njësinë përkatëse).
7. Vërtetim për taksat kombëtare pa detyrim për rentën minerare.
8. Subjektet që kanë të miratuar nga MIE pezullimin e përkohshëm të aktivitetit të tyre mineral, duhet të dorëzojnë dosjen në datën efektive të lejes, në rast se fillon aktivitetin të dorëzojë dosjen e plotë.

III. Dokumentacioni Juridik:

1. Ekstrakti historik me status aktiv;
2. Autorizim/ prokurë përfaqësimi;
3. Kontratë me Drejtuesin Teknik, orgjinale ose e noterizuar;

Adresa: Bulevardi " Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë, Shqipëri.
Tel. - 355 (0) 4 225 7117; Fax +355 (0) 4 225 7382

4. Licencën e Drejtuesit Teknik të marrë në MIE, e noterizuar;
5. Dokumenti nga Shoqëria e Sigurimit për sigurimin e jetës punonjësve shoqëruar me formularet përkatëse Esig-25. Për drejtuesin teknik duhet të dorëzojnë Esig-25 dhe në rastet kur ndryshon drejtuesin teknik duhet të sjellë Esig-27. Për minierat sipërfaqësore duhet të jenë të pajisur me sigurim jete jo me pak se tre persona, Drejtuesin Teknik + dy punonjës, ndërsa për minierat nëntokësore i gjithë personeli i nëntokës duhet të jenë të pajisur me sigurim jete.

Handwritten signatures and names:
Renaldo Jusaj, [Signature], [Signature], [Signature], [Signature]